

A K T T H E M E L U E S
I SHOQERISE PRIVATE "FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F"



Unë i nenshkruari:

DRITAN DEMIRAJ, i biri i Baki-ut, lindur në Tiranë, më 24.01.1962, banues në Tiranë, rruga « Karl Topia », Pall. 2, sh.3, ap.1, i identifikuar nga certifikata me foto me nr.29-66 lëshuar më 13.10.2005 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake 7, Tiranë.

Mbeshtetur në nenin 251, shkronja "c" të ligjit nr. 7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismes së lire të veprimtarisë private dhe privatizimit", krijojmë shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar të quajtur "**FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F**" sh.p.k. dhe hartojmë këtë akt themelues si vijon:

FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqëria private e quajtur "**FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F**" sh.p.k. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë degë.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të kësaj akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

Neni 2

Selia e shoqërisë private "**FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F**" sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga "Karl Topia", Pall.2, shk.3, ap.1, Tiranë.

Shoqëria do të hapë edhe vend-qendrim të tjera të dyta, dege, filiale, përfaqësi dhe agjensi, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarisë private do të ushtrojë aktivitetet me objekt:

- a. Sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.



b. Sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetiut të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj.

Shoqeria do të pajiset me license nga Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit duke plotësuar të gjitha kërkesat për këtë qëllim.

Neni 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqeria do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 5

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqërisë private **"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F " sh.p.k** do të jetë 4.000.000 leke dhe do të përbehet nga kuotat e ortakut të vetëm themelues të shoqërisë si vijon:

DRIITAN DEMIRAJ.....100%

Kapitali themelues fillestar mund të shtohet ose pakesohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve. Kapitali themelues ndahet në kuota, vlera nominale e të cilave është 1000 (njemijë) Leke secila. Kuotat e pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emëruara dhe të pandashme. Kapitali është teresisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Neni 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos demtojnë interesat e personave të tjerë e të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqeria do të drejtohet nga administratori i ortakut i vetëm i shoqërisë, **z.Dritan DEMIRAJ**. Administratori ka të drejtë të administrojë pasurinë e shoqërisë dhe të kryejë të gjitha veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë e shoqërisë.

Neni 9

Ortakët caktojnë dhe administratore të tjere të vlerave materiale të shoqërisë. Ata kanë të drejtë të caktojnë financiere, likuidator për problemet e shoqërisë, si dhe të pajtojnë persona të tjere si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesin financiar tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

Neni 10

Drejtues teknik i shoqërisë është Rezo Çulli, i biri Sulo, i datëlindjes 03.01.1946, banues në Tiranë, i cili është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin e veprimtarisë së shoqërisë për sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizike e juridike dhe për sigurimin e jetes dhe shëndetit të personave fizik shtetas shqiptar apo të huaj. Ai do të bëjë përgatitjen profesionale dhe kualifikimin e punonjësve të shoqërisë dhe pajisjen me dokumentacionin përkatës.

Neni 11

Te ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë në proporcion me kuotat e tyre në kapitalin fillestar.

Neni 12

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen sipas statutit të shoqërisë, kontratës të lidhur me palët dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar.

Neni 13

Shoqëria ka vullen e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

Neni 14

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të ligjit nr. 7368 datë 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqërive tregtare".




Neni 15

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

Neni 16

Akti i themelimit u perpilua ne kater kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private **"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k.**

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem themelues.



ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k

DRITAN DEMIRAJ

Dritan DEMIRAJ

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANË

Nr. 4098 Rep.

Nr. 291 Kol.

VERTETIM

Sot, me date 5.12.2005 (Dy mijë e pese) para meje noterës Pranvera Karalili, ne zyren e Noterise me seli rruga "Myslym Shyri", Pall.46/1 Tirane u paraqitën personalisht para meje:

DRITAN DEMIRAJ, i biri i Baki-ut, lindur në Tiranë, më 24.05.1969, banues ne Tirane, rruga « Karl Topia », Pall. 2, sh.3, ap.1, i identifikuar nga certifikata me foto me nr.29-66 lëshuar më 13.10.2005 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake 7, Tiranë, madhorë me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili konfirmoi nenshkrimin e tij ne aktin e themelimit të shoqerise **"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k.** si me siper me vullnetin e tyre te lire e te pavesuar dhe une noterja pasi u binda per shprehjen e vullnetit te tyre e vertetova ate sipas ligjit.

NOTER
Pranvera Karalili
[Signature]



S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k



Ne baze te ligjit 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe shpalljen e pronave private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit" dhe te ligjit 4888 dat 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues, ortaku i vetem:

DRITAN DEMIRAJ, i biri i Bakiut, lindur ne Tiranë, më 24.05.1969, banues ne Tiranë, rruga "Karl Topia", Pall. 2, shk.3, ap.1, i identifikuar nga certifikata me foto me nr 29-66 lëshuar më 13.10.2005 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake 7, Tiranë.

Hartoj statutin e shoqerise private **"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k** si vijon:

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, KAPITALI, OBJEKTI.

Neni 1

Shoqeria emertohet **"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k.**

Neni 2

Selia e shoqerise private **"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k** do te jete ne Tiranë ne adresen: Rruga "Karl Topia", Pall.2, shk.3, ap.1

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe me 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregtar, prane Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarise private do te ushtroje aktivitet me objekta:

- a. Sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike qe ushtrojne veprimtari ne Republikën e Shqipërisë.
- b. Sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetiut të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj.

Shoqeria do te pajiset me license nga Drejtoria e Pergjitheshme e Policise se Shtetit duke plotesuar te gjitha kerkesat per kete qellim.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private **"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F" sh.p.k** do te jete 4.000.000 leke dhe do te perbehet nga kuotat e ortakut të vetëm themelues te shoqerise si vijon:

DRITAN DEMIRAJ.....100%

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve. Kapitali themeltar ndahet ne kuota, vlera nominale e te cilave eshte 1000

(njemijet) Leke secila. Kuotat e pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

Neni 6

Ortaku qe ka ndermend te shese kuotat e tij, teresisht apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje me shkrim ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejte ortakut duhet ta ushroje brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mosushtimit te se drejtes se blerjes se pare, ortakut qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se ato te ofruara ortakut tjeter te shoqerise.

Neni 7

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj, te nevojshme per ushtimin e aktivitetit te shoqerise.

Neni 8

Kuotat e kapitalit fillestar jane depozituar ne nje numer llogarie ne nje Bankë ne Republiken e Shqiperise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise se shoqerise.

Neni 9

Heqja dore e ortakut nga bashkpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton dhe te drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

Neni 10

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve, ne proporcion me perqindjet e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund te kaloje kuotat e percekuar ne kapitalin fillestar. Rritja e kapitalit nga ortakët do te behet vetem me vendim unanim te Asambles se ortakeve.

Shoqeria «**FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F**» sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria «**FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F**» sh.p.k. gezon te drejta sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 11

Shoqeria «**FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F**» sh.p.k vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortakët themelues te shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortakët kane patur para se ajo te krijohet.

KREU I DYTE

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Drejtues teknik i shoqërisë është **Rezo Çulli**, i biri Sulo, i datëlindjes 03.01.1946, banues ne Tiranë, banues ne Tiranë, rruga «Vaso Pasha», Pall. 14, sh.2, ap.15, i cili eshte



drejtuesi me i larte teknik i shoqerise dhe pergjigjet per drejtimin, bashkerendimin dhe shoqerimin e vlerave monetare e materiale ose te sendeve te cmuara gjate transportit te tyre. Ai do te beje pergatitjen profesionale dhe kualifikimin e punonjesve te shoqerise dhe pajisjen me dokumentacionin perkates.

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asamblea e ortakut te vetem.

Administratori.

Komisioni i revizionimit.

Lusha e veprimit,perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohet ne statut.Asambleja e shoqerise perbehet nga ortakët themelues.

Themeluesit e shoqerise e qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private te investuar ne kete shoqeri.

Vendimet qe merr Asambleja jane te detyrueshme per ortakët e shoqerise. Asambleja thirret sa here e sholin te arsyeshme ortakët themelues te shoqerise, por detyrimisht ne dhjetor per te miratuar programin e veprimtarise per vitin e ardhshem dhe ne Mars per te miratuar bilancin kontabel te vitit te meparshem.

Neni 13

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i caktuar nga ortakët themelues te shoqerise. **Administrator do te jete Dritan DEMIRAJ.**

Neni 14

Hijne brenda detyrave dhe kopetencave te Asamblese se ortakeve si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i hlogarit te hlogarise.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave e i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i emimeve dhe i tarifave te sherbimeve te saj.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i vules dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer, per hlogar dhe per interes te saj.

Neni 15

- 1- Administratori, perfqeson shoqerine me te tretet, kujdeset per funksionimin normal e te perditshem te shoqerise ose te pjeseve te vecanta te aktivitetit te saj.
- 2- Pregatit dekuamentacionin dhe relacione te ndryshme per gjendjen ekonomiko-financiare te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi, kordinon veprimtarine e personelit te punesuar ne shoqeri.
- 3- Ndjek ceshtje te ndryshme te shoqerise, me organzmat e tjere shteterrnore apo private.



- 4- Kompetencat e administratorit dhe administratoreve te mundshem jo-ortak, ne menyre te pergjithshme percaktohen ne statut dhe detajohen e konkretizohen ne aktin e tyre te emerimit.

Administratori jo-ortak pervec detyrave qe i caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra dhe te drejta:

1. Te mireadministroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marrveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise te shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaket.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te pergjigjet per demet qe i sjell shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen e kryer ne baze te marrveshjes se bere me ortaket.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithcka qe e cmon te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

KREU I TRETE TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

Neni 16

Shoqeria ka te drejte:

1. Te importoje dhe te eksportoje mallra ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te hua ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjilacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

Neni 17

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin fillestar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe kryen.
3. Te siguroje punonjesit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektojte standartet shteterore si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

KREU I KATERT MARRDIHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

Neni 18

1. gjithë veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.



Neni 19

Ne selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti nxirret bilanci.

Neni 20

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 21

Shoqëria mban xhiro-llogarite në Banke. Llogarite mbahen në lekë dhe pasqyrohen në librat përkatëse.

Neni 22

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, shoqëria, pasi ben zbritjet e humbjeve të vitit të mëparshëm, le mënjane 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond të arrijë në masën 10% të kapitalit themeltar.

Neni 23

Te ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendura më sipër dhe pagimit të detyrimeve fiskale, i mbesin në përdorim ortakëve të shoqërisë.

Fitimi i realizuar nga shoqëria do të ndahet midis ortakëve të saj në përputhje me kapitalin e investuar por pa kaluar përqindjet e përcaktuara në kapitalin fillestar. Ndarja e dividendëve bëhet sipas mënyrës dhe në afatet që vendos asambleja e shoqërisë. Komercimi i parave të realizuar nga shitja do të bëhet sipas kushteve që do të ketë Banka e Shtetit Shqiptar ose bankat e tjera private dhe transferimi i saj do të bëhet në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

KREU I PESTE DISPOZITA TË VECANTA

Neni 25

Shoqëria ka vulën e vet dalluese.

KREU I GJASHTË SHINDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQËRISE


Neni 26

Shindrrimi i shoqërisë "FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F " sh.p.k në shqiptar të tipeve të tjera, mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së ortakëve.

Neni 27

Shperberja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfardo shkak, si:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë,
- Pamundësi veprimi,
- Me vendim të Asamblese së ortakëve.



Ne keto raste, pronaret e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke ju caktuar edhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise perderisa ajo tu dorezohet personave perkates fizik apo juridik, duke likuiduar ne mradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund ti kerkoje ortakut themelues te shoqerise qe te derdhe kuotat qe i takojne atij respektivisht.

DOSPOZITA TE PERGJITHSIEME

Neni 28

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortakët themelues, si edhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne menyren dhe proceduren me te cilen nvsirret statuti.

Neni 29

Ky statut perpilohet ne kater kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise private "FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F " sh.p.k

CPTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

"FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F " sh.p.k.

DRITAN DEMIRAJ

DRITAN DEMIRAJ

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DIHOMAL NOTERËVE TIRANË

Nr. 4099 Rep.

Nr. 292 Kol.

PULLE TAKSE



VERTETIM

Sot, me date 6.12.2005 (Dy mijë e pese) para meje noteres Pranvera Karafili, ne zyren e Noterise me seli rruga "Myslym Shyri", Pall.46 1 Tirane u paraqitë personi me emrin **DRITAN DEMIRAJ**, i biri i Baki-ut, lindur në Tiranë, më 24.05.1969, banues ne Tirane, rruga « Karl Topia », Pall. 2, sh.3, ap.1, i identifikuar nga certifikata me foto me nr 99-66 lëshuar më 13.10.2005 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake 7, Tiranë, madhorë me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili konfirmoi nenshkrimin e tij ne statutin e shoqerise "FIRDEUS SECURITY SH.R.S.F " sh.p.k si me siper me vullnetin e tyre te lire e te pavesuar dhe une noterja pasi u binda per shprehjen e vullnetit te tij e vertetojate sipas ligjit.

NOTER

Pranvera Karafili

[Signature]